



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.75, datë 19.06.2020

“PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR AMENDIMIN E MARRËVESHJES SË HUASË NR. 49161, DATË 19.03.2018 NDËRMJET SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM E ZHVILLIM (BERZH) “ZGJERIMI I IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË BOVILLËS DHE NDËRTIMIT TË NJË LINJE TË RE FURNIZIMI PËR PJESËN PERËNDIMORE TË BASHKISË TIRANË”

Në mbështetje të pikës 1.1 germat “a” dhe “b” të nenit 9 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 135 dhe 213, pika 1 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore; Ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; Vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sha”, shkresën nr. 9799 prot., datë 15.06.2020 të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, si dhe shkresën nr.8832 prot, datë 02.06.2020 të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me propozim të Kryetarit të bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit për amendimin e marrëveshjes së huasë nr. 49161, datë 19.03.2018 ndërmjet shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha dhe Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim (Berzh) “Zgjerimi i impiantit të përpunimit të ujit të Bovillës dhe ndërtimit të një linje të re furnizimi për pjesën perëndimore të Bashkisë Tiranë” dhe autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, të negocioj dhe të nënshkruajë amendamentin e kësaj kontrate, për përdorimin e shumës së papërdorur të marrë hua nga ky institucion financiar.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU